



Prishtinë, 20 dhjetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1083_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafet 1.11 dhe 1.12, Nenin 26, Nenit 28 paragrafi 2, nënparagrafi 2.10, Nenin 30, Nenin 32 paragrafin 2 nënparagrafi 2.2, dhe Neni 3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 33 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085)
- Dispozitat e Nenit 4, Nenit 6 dhe Nenit 16 paragrafi 5, të Rregullës për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë (Rregulla Nr.07/2017); si dhe
- Aplikacionin për Licencim të Aktivitetit të Furnizimit me Energji Elektrike të dorëzuar në Rregullator me datë 30.03.2017 nga ndërmarrja **Korporata Energjetike e Kosovës SH.A**, adresa Rruga, "Nënë Tereza" Nr.36, Prishtinë, Republika e Kosovës.

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018, nxori këtë:

VENDIM

- I. LËSHOHET** Licenca për Furnizim me energji elektrike ndërmarrjes "**Korporata Energjetike e Kosovës**" SH.A (KEK SH.A.), me numër licence **ZRRE/Li_60/17** për periudhën nga **20 dhjetor 2018** deri **19 dhjetor 2043**.

Arsyetim

- Zyra e Rregullatorit për Energji (Rregullatori) me datë 30.03.2017 ka pranuar Aplikacionin me dëshmitë përkatëse për Licencim të aktivitetit të Furnizimit me energji elektrike në Kosovë nga ndërmarrja "**Korporata Energjetike e Kosovës**" SH.A.
- Rregullatori ka vlerësuar se ndërmarrja në fjalë ka vepruar sipas udhëzimeve të Rregullatorit, kërkesave të parapara në Aplikacionin për Licencim të aktivitetit të furnizimit me energji elektrike dhe legjislacionit në fuqi.
- Sipas Nenit 8.1 të Rregullës për licencimin e aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, ndërmarrjet që aplikojnë për Licencim në Rregullator duhet të njoftojnë përmes gazetës palët e interesit se kanë dorëzuar një aplikacion në Rregullator për Licencë të Furnizimit me energji elektrike dhe se ai aplikacion është në fazën finale për marrje të licencës. Palët e interesit kanë të drejt të kundërshtojnë aplikacionin, nëse dëshmojnë ndonjë parregullsi të tij.



- Ndërmarrja KEK SH.A. me 23.11.2018 ka publikuar njoftimin në gazetë, në pajtim me paragrafin e sipërpërmendur dhe palët e interesit nuk kanë kundërshtuar këtë aplikacion.
- Rregullatori pas vlerësimit të aplikacionit dhe dëshmive tjera të bashkangjitura aplikacionit të ndërmarrjes KEK SH.A dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.
- Rregullatori në përputhje me Rregullën për licencimin e aktiviteteve të energjisë në Kosovë, merr një vendim formal për secilin aplikacion për Licencë brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh kalendarike, nga data kur aplikacionin e konsideron të kompletuar.

II. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


III. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.


Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.


Vendimi i dërgohet:


- Ndërmarrjes “Korporata Energjetike e Kosovës” SH.A.
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:


Arsim Janova, u.d. Kryesues


Besim Sejfiqaj, anëtar


Izet Rushiti, anëtar


Selman Hoti, anëtar